



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 452/5 prot.

Tiranë, më 14.11.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 704, datë 9.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 1.11.2023, është njoftuar vendimi nr. 704, datë 9.10.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës<sup>1</sup>.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit 704, datë 9.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Sarandë dhe, aktualisht, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm,

<sup>1</sup> Referuar deklarimit të subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore.

Durrës. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 12 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme (referuar në vijim si *GPP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Elidon Hysenaj*”, nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.4.2019, ka konstatuar:

- (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, fillimisht me anë të raportit<sup>3</sup> të parë mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. *Elidon Hysenaj*, i cili është përpiluar pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit...*”. Në vijim, me shkresën e datës \*\*.11.2022, AKSIK i ka përcjellë Komisionit një raport të dytë, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022<sup>4</sup>, ku ka ndryshuar konstatimin fillestar nga *përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës për subjektin Elidon Hysenaj*.

2.3 **GPP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>5</sup> për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. *Elidon Hysenaj*.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se z. *Elidon Hysenaj* ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm burimin financiar për të gjitha pasuritë e analizuar<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>3</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, i DSIK-së.

<sup>4</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2022, të KDZH-së.

<sup>5</sup> Raporti me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.7.2018, i GPP-së.

<sup>6</sup> Referohuni f. 21 të vendimit të Komisionit.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Në përfundim, në vlerësim të rezultateve të hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit Elidon Hysenaj, Komisioni ka konstatuar se indiciet nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, të rezultuara gjatë hetimit administrativ. Vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë qëndrimin e tij lidhur me veprimet hetimore të kryera, në raport me detyrimin e tij për arsyetimin ligjor e argumentin logjik të përdorur rast pas rasti gjatë hetimit të çështjeve të analizuara. Sipas Komisionit, parë në tërësinë e tyre, të gjitha indiciet e mbledhura në raport me veprimet procedurale hetimore konkrete të subjektit të rivlerësimit, për çështjet objekt shqyrtimi, konstatohet se nuk përmbajnë të dhëna të nevojshme për të vlerësuar se ka rrethana që krijojnë bindjen se subjekti me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te drejtësia dhe as nuk mund të konkludohet se ka pasur shkelje ligjore që mund të kualifikohen brenda dispozitave të kreut V, “Kontrolli i figurës”, apo konkretisht nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, apo të përbëjnë mangësi profesionale<sup>7</sup>.

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Nisur nga analiza e kryer lidhur me: (i) Raportin të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) denoncimet e depozituara nga publiku dhe dokumentacionin e administruar për këtë qëllim; (iii) shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij – Komisioni ka çmuar se, në një vlerësim të përgjithshëm të këtij subjekti, nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore e serioze në lidhje me kryerjen dhe drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij, kësaj nuk janë konstatuar mangësi me peshë evidente në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se, bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Elidon Hysenaj ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

4. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës*<sup>8</sup>.

## II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Përpara se të vijohet me trajtimin e çështjeve objekt ankimi dhe për të cilat Kolegjit do t’i kërkohet t’i shqyrtojë në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të njohur nga Kushtetuta, paraprakisht, çmojmë të sjellim në vëmendje të Kolegjit kompetencën kushtetuese të Komisionerit Publik, si një ndër organet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik<sup>9</sup>, *i cili nuk merr pjesë në procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision*, por është titullar i së drejtës për të parashtruar ankim<sup>10</sup>, kur çmon se vendimmarrja e Komisionit, rast pas rasti, nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe provat, apo subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet që duhet të konfirmohet në detyrë.

<sup>7</sup> Referohuni f. 28-29 të vendimit të Komisionit.

<sup>8</sup> Aktualisht, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore.

<sup>9</sup> Neni C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës.

<sup>10</sup> Neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

5.1 Në analizë të kuadrit ligjor të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit, bazuar dhe në një qëndrim të konsoliduar tashmë, të shprehur në jurisprudencën e Kolegjit, Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin dhe Kolegjin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve, bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

5.2 Mbajmë parasysh këtu faktin se neni Ç, paragrafi 4 i aneksit të Kushtetutës i jep shprehimisht Komisionit dhe Kolegjit kompetenca të gjera për t'i investiguar dhe verifikuar vetë çështjet, që evidentohen qoftë edhe në raportet e organeve ndihmëse të procesit, që administrojnë informacion të klasifikuar. Sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, organet zyrtare duhet të bashkëpunojnë dhe të venë në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelit, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në databazën e tyre. Po ashtu, neni 45 i ligjit nr. 84/2016, i lejon anëtarët e Komisionit dhe të Kolegjit të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes.

5.3 Ndërkohë, ndryshe nga dy organet e tjera të rivlerësimit, bazuar edhe në ecurinë e deritanishme të praktikës gjyqësore të procesit, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij në mbrojtje të interesit publik dhe në funksion të ushtrimit ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në gjendjen që ato janë, brenda afatit ligjor<sup>11</sup>, pa pasur vetë mundësinë të kryejë hetime, të bëjë vlerësim të provave dhe të marrë vendim bazuar në to dhe në bindjen e tij të pavarur.

6. Sa më sipër, Komisioneri Publik, gjatë shqyrtimit të vendimit nr. 704, datë 9.10.2023, konstaton se Komisioni lidhur me kontrollin e kriterit të figurës të subjektit të rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, ka referuar se fillimisht DSIK-ja ka dërguar Raportin mbi kontrollin e figurës me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, i përpiluar pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese, me të cilin ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*.

6.1 Me tej, me shkresat e datave \*\*.7.2018 (me nr. prot. \*\*\*) dhe \*\*.7.2022 (me nr. prot. \*\*\*), ish-DSIK<sup>12</sup> i ka bërë me dije Komisionit se, nëpërmjet përgjigjeve dhe komunikimeve me organet ligjzbatuese [...] *me shkresën e datës \*\*.5.2018 e në vijim, është njoftuar prezenca e të dhënave lidhur me dyshime se subjekti Elidon Hysenaj ka favorizuar disa persona, përgjatë kryerjes së funksionit të tij si prokuror nëpërmjet mitmarrjes, duke u përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, si korrupsion pasiv dhe shpërdorim detyre [...]. DSIK, me shkresën e datës \*\*.11.2022, i ka përcjellë Komisionit një raport të dytë, ku ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri [...] në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj [...].*

6.2 Komisioni, në paragrafin 91 të vendimit nr. 704/2023, referon se: [...] *në vijim dhe vlerësim të të dhënave që disponoheshin lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, nisur nga informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese dhe pasi janë aksesuar informacionet e klasifikuara pranë organit kompetent, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke kërkuar*

<sup>11</sup> Referuar nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 [...]15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit [...].

<sup>12</sup> Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.10/2023, datë 2.2.2023, "Për informacionin e klasifikuar", më datë 9.3.2023, që ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji, emërtimi i DSIK-së ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

*informacione dhe dokumentacione shitesë. Gjithashtu janë administruar dhe analizuar disa akte, vendime e dosje, që lidheshin me çështjet penale, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara të bëra me dije edhe nëpërmjet aksesimit të dokumenteve e informacioneve të klasifikuara, që lidheshin me kriterin e figurës [...].*

7. Sa më sipër, Komisionerit Publik, gjatë shqyrtimit të vendimit nr. 704/2023 dhe akteve bashkëlidhur tij, iu mundësua nga Komisioni vënia në dijeni, me përmbajtjen e plotë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022 të DSIK-së, me anë të së cilës ky organ në vijim të informacioneve të ardhura nga organet ligjzbatuese, në mënyrë të përmbledhur, ka referuar se në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit [...] *dyshohet për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në korrupsion pasiv, ka të dhëna për favorizime të shtetasve kundrejt mitmarrjes apo të dhëna që disponohen në lidhje me përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme në formën e shpërdorimit të detyrës [...].*

7.1 Komisioneri Publik sjell në vëmendje të Kolegjit, që vetë ai si institucion, nuk ka akses mbi informacionin e disponuar prej institucionit informues burimor, pasi, sikurse është trajtuar dhe më parë gjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegji, pavarësisht urdhërimit gjyqësor të Kolegjit, për t'i mundësuar Komisionerit Publik njohjen me të dhënat në burim për në rastin konkret<sup>13</sup>, për shkak të pretendimeve verbale nga ky institucion në lidhje me administrimin e informacionit të klasifikuar, nuk u mundësua një akses i tillë, fakt i cili pamundëson objektivisht Institucionin e Komisionerit Publik për t'u njohur me të.

7.2 Në këto rrethana, në kushtet kur nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, duket se pothuaj të gjitha problematikat e konstatuara në kriterin e kontrollit të figurës janë prezantuar nëpërmjet informacioneve të organeve ligjzbatuese, Komisioneri Publik, në mungesë të një njohje të mjaftueshme të tyre (informacioneve), vlerëson të rivendosë në vëmendje të Kolegjit dosjet penale të trajtuara në kuadër të vlerësimit të njëkohshëm të profesionalizmit lidhur me kontrollin e figurës nga Komisioni në këtë vendim, pasi mund të marrin kuptim e tjetër peshë në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese.

7.3 Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet në dosje, çmon se, për rrethanat e parashtruara më lart, nga ana e këtij institucioni pamundësohet vlerësimi nëse në vendimin nr. 704/2023 gjenden mjaftueshëm elemente për të identifikuar dhe vlerësuar drejt rezultatet e hetimit administrativ, të cilat kanë çuar Komisionin në konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe nëse në këto rezultate ka problematika që afektojnë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit dhe duhen vlerësuar sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që konkludojnë në cenimin e besimit të publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7.4 Në analizë të sa më sipër, në rastin konkret nisur edhe nga numri dhe periudha e shkurtër gjatë të cilës janë administruar informacionet nga agjencitë ligjzbatuese, Komisioneri Publik parashtron para Kolegjit nevojën për verifikimin në burim të përmbajtjes së këtyre informacioneve, trajtimin procedural të tyre dhe krahasimin eventualisht me praktikën e administruara, për sa kohë që aktet në dosje nuk japin të dhëna që mund të analizoheshin dhe të mundësonin mbajtjen e një qëndrimi rreth këtij kriteri. Vetëm në këto rrethana, gjetjet në rastet e trajtuara nga Komisioni nën regjimin e informacionit të klasifikuar si “sekret shtetëror”,

---

<sup>13</sup> Referuar vendimit (JR) nr. 27/2021, prg. 18.8 i tij.

do të krijojnë një panoramë të plotë të kontrollit të besueshmërisë për konfirmimin ose jo në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

7.5 Komisioneri Publik, së bashku me 6 (gjashtë) praktikantët e administruara si rezultat i informacionit të organeve ligjzbatuese, parashtron në shkaqet e ankimit dhe gjetjet nga dy denoncime nga publiku, të cilat duket se përmbajnë fakte apo rrethana, që mund të përbëjnë provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe si të tilla duhet t'i nënshtrohen hetimit gjyqësor.

7.6 Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ushtrohet ndaj vendimit nr. 704, datë 9.10.2023, të Komisionit, në tërësinë e tij.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

8. Subjekti i rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, ka ushtruar detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore, nga viti 2004 deri në nëntor të vitit 2015<sup>14</sup>, kur me dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. \*\*\*, datë 2.11.2015, është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.

9. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është bazuar në administrimin e të gjitha burimeve të vlerësimit, verifikimin dhe analizimin e tyre, ndër të tjera, dhe: (i) *Raportit për kontrollin e figurës dhe informacionit të aksesuar pranë organeve ligjzbatuese; si dhe (ii) Denoncimeve nga publiku*. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik çmon se gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, janë për sa në vijim:

10. *Lidhur me gjetjet në Raportin e DSIK-së*. Nisur nga informacionet e referuara nga organet kompetente për kontrollin e figurës, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë dhe Prokurorisë pranë kësaj Gjykate, nga ku ka administruar dokumentacionin përkatës për 6 praktika të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, si vijon.

11. *Procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*.8.2018, me të dyshuar shtetasin \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, të akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal*

11.1 *Rrethanat e faktit*. Më datë \*.8.2018, shërbimet e Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Sarandë kanë ndaluar një automjet, në të cilin ndodheshin dy persona, të identifikuar me gjeneralitetet \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar, shtetasit \*\*\*, \*\*\*, iu gjet në xhep një qese plastike me ngjyrë blu, brenda së cilës gjendej pluhur i bardhë me aroma dhe karakteristika të ngjashme me atë të lëndës narkotike “kokainë”. Gjatë kontrollit të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, i është gjendur një sasi vlerash monetare në shumën 3.555 euro dhe 41.000 lekë. Njëkohësisht është ushtruar kontroll dhe në mjetin me targë \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, i cili ndodhej i parkuar në këtë rrugë. Gjatë kontrollit të këtij mjeti është gjetur një qese plastmasi, me ngjyrë blu, brenda së cilës gjendej një bohçe bimore në gjendje të thatë, me ngjyrë jeshile.

---

<sup>14</sup> Gjatë kësaj periudhë ka ushtruar detyrën si OPGJ, në Prokuroritë pranë Rrethit Gjyqësor në Fier, Vlorë, Tiranë dhe Prokurorinë për Krimet e Rënda.

11.2 Policia ka kryer dhe veprimin e përgjimit ambiental të këtyre personave, në ambientet e Komisarariatit, dokumentuar me procesverbalin e datës \*\*.8.2018, ku, ndër të tjera, rezulton e transkriptuar se shtetasi \*\*\*. \*\*\*. i thotë shtetasit \*\*\*. \*\*\*.: [...] *Dëgjove ça thashë unë, e lini atë i thuaj të dali... Nuk e di unë po të them, ta kesh parasysh dalë unë të flas me njeri, ndonjë gjë, të jap lekë. Andej po të them unë thuaj kshu, ti e di vet, unë po të them, mos ta mbajmë kot të dy. Kij parasysh këto që thashë unë në rregull?*[...] Pas verifikimeve paraprake dhe akteve përkatëse, Policia ka vijuar me arrestimin në flagrancë të shtetasve të mësipërm, si të dyshuar për veprën penale të “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal, arrestim i cili është kryer po më datë \*\*.8.2018. Më tej, materialet janë referuar organit procedues.

11.3 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.8.2018, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, kërkesën për “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit ‘Arrest me burg’ në ngarkim të të dyshuarve, shtetasve \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*.”. Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e organit të akuzës, ka argumentuar se këta dy shtetas [...] *këtë sasi droge mund dhe ta tregtonin ose shpërndanin, nisur nga fakti se në momentin e arrestimit, shtetasit \*\*\*. \*\*\*. i është gjetur një sasi monedhash të konsiderueshme, çka janë të dyshueshme, për vetë faktin se \*\*\*. \*\*\*. është student sipas tij (edhe pse s’ka asnjë vërtetim që është student) dhe faktit tjetër që është i papunë [...].*

11.4 Me vendimin nr. \*\*-2018-\*\*\*, datë \*\*.8.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë Sarandë për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasve \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*, dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”. Ky vendim është ankimuar vetëm nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*.<sup>15</sup>, ndërsa për shtetasin \*\*\*. \*\*\*, vendimi nuk është ankimuar nga palët. Nga përmbajtja e akteve të administruara rezulton se, më datë \*\*.9.2019, shtetasi \*\*\*. \*\*\*. ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” ose “Garanci pasurore”.

11.5 Gjykata e Sarandës, me vendimin nr. \*\*-2018-\*\*\*, datë \*\*.9.2018, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”, në garanci pasurore, në shumën 300.000 lekë, vendim ky që ka marrë formë të prerë më datë \*\*.19.2018, pasi nuk është ankimuar nga palët<sup>16</sup>. Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës të datës \*\*.9.2018, rezulton se dhe organi i akuzës ishte [...] *dakord me zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi rrethanat e faktit janë zbehur, çështja është nën hetim dhe vendosja e masës së sigurimit garanci pasurore është më e përshtatshme [...].*

11.6 Sa më sipër rezultuar, Komisioni ka ftuar subjektin të jap shpjegime lidhur me qëndrimin e tij *mbi ndryshimin e masës së sigurimit nga arrest me burg në garanci pasurore*. Në përfundim, Komisioni, pasi ka analizuar përgjigjet e subjektit në funksion të rezultateve të

<sup>15</sup> Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*-2018-\*\*\*/\*\*, datë \*\*.8.2018, ka vendosur miratimin e vendimit penal.

<sup>16</sup> Në vendimin e Gjykatës, ndër të tjera, referohen dhe provat e administruara deri në këtë moment procedural, si: (1) Deklaratë personale e datës \*\*.8.2018, e shtetasit \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*. (babai i të dyshuarit), ku theksohet, midis të tjerash, se: [...] *vlera monetare prej 3.500 euro ia kam dhënë unë djalit tim \*\*\* \*\*\*, për arsye që djali im të kalonte pushimet verore në qytetin e Sarandës së bashku me shoqërinë e tij [...].* (2) *Ekstrakt Historik i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit Person Fizik, printuar nga sistemi datë 22.8.2018, ku pasqyrohet që i dyshuari të jetë i regjistruar si person fizik në ushtrimin e veprimtarisë “Bar-Kafe” në qytetin e Fierit.* (3) Akti i ekspertimit nr. \*\*\*, datë \*\*.8.2018, që referon se në sipërfaqen e objektit të ekspertimit, fiksuar si provë materiale gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes [...] *fiksim prove material në automjetin me targa \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, ndodhur në datë \*\*.8.2018, Sarandë, nuk ka gjurmë papilare të vlefshme për identifikim [...].*

hetimit, ka arritur në përfundimin se subjekti ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe shteruese zëvendësimin e masës së sigurimit. Në këto kushte nuk ka konstatuar indicie lidhur me favorizim të mundshëm të të dyshuarit në çështjen në analizë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

11.7 Komisioneri Publik, nga aktet e vëna në dispozicion nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.9.2018, ka marrë vendimin për njoftimin e akuzës dhe marrjen të pandehur të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, për veprën penale “Moskallëzim i krimi”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

11.8 Në vijim, duket se subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.10.2018, ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes nr. \*\*\*/2018, në gjyq, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, (regjistruar më datë \*\*.11.2018), kundër të pandehurit \*\*\*. \*\*\*, si të akuzuar për veprën penale të “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, dhe për shtetasin \*\*\*. \*\*\*, si i akuzuar për veprën penale të “Moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

11.9 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Sarandë, me vendimin nr. \*\*-2018-\*\*\*, datë \*\*.12.2018, ndër të tjera, ka vendosur: [...] *Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*. \*\*\*, për veprën penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal dhe dënimin e tij me 45 ditë burg. Shuarjen e masës së sigurimit “garanci pasurore” [...].*

11.10 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në rastin konkret, pranimi nga ana e subjektit e nevojës së ndryshimit të masës së sigurisë, gjatë seancës gjyqësore, sipas kërkesave të palës, duket e paargumentuar qartë. Në kushtet kur ky rast është administruar si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, Komisioneri Publik, me këtë bazë të dhënash dhe këtë nivel aksesit mbi informacionin e klasifikuar, nuk është në kushtet për të verifikuar nëse ndryshimi i masës së sigurisë për shtetasin \*\*\*. \*\*\*, ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës.

## **12. Procedimi penal nr. \*\*, datë \*\*.1.2017, me të pandehur shtetasin \*\*\*, \*\*\*, i akuzuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”<sup>17</sup> dhe “Ndotja e ujërave”<sup>18</sup>**

12.1 Mbi bazën e materialit kallëzues të Komisarariatit të Policisë Sarandë, të datës \*\*.1.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/2017.

12.2 Rrethanat e faktit. Më datë \*\*.1.2017, është njoftuar Salla Operative e Komisarariatit të Policisë Sarandë, se shtetasi \*\*\*. \*\*\*, po hidhte inerte në det, me qëllim ndërtimin e një objekti. Pas këtij njoftimi, shërbimet e policisë kanë shkuar në vendngjarje, ku kanë konstatuar një grumbull dheu me përmasa 4.2x3.4 dhe lartësi 1.3 m, i cili kufizohej nga lindja me lokalit e shtetasit \*\*\*. \*\*\*, nga perëndimi me det, nga veriu me një objekt dhe nga jugu, plazhin. Në vendngjarje është konstatuar dhe një mol i ndërtuar me material guri, me gjerësi dhe lartësi të ndryshme, dhe këto përmasa ndryshonin në drejtim të zgjatimit të molit drejt detit. Nga verifikimi ka rezultuar se këto punime janë kryer nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*. Ky person ka deklaruar se këtë material e ka hequr nga lulishtja para lokalit, pranë vendit ku ishin hedhur materialet e

<sup>17</sup> Neni 199/a/2, “Ndërtimi i paligjshëm”, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

<sup>18</sup> Neni 203/1, “Ndotja e ujërave”, dënohet me burgim 1 gjer në 5 vjet.



interteve dhe molit të gurit. Për kryerjen e këtyre punimeve ka deklaruar se është ndihmuar nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*.

12.3 Policia Gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit \*\*\*. \*\*\*. dhe shtetasit \*\*\*. \*\*\*, si të dyshuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm, të parashikuar nga neni 199/a/2 i K. Penal dhe “Ndotja e ujërave”, të parashikuar nga neni 203/1 i K. Penal.

12.4 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, më datë \*.1.2017, ka hartuar kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, për shtetasit \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*.\*\*\*I., paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me datë \*.1.2017. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] për sa i përket kriterit “gjendje flagrante”, në rastin konkret kjo gjendje ka ekzistuar, pasi këta persona janë kapur në kryerje e sipër të veprës penale... plotësohet kriteri i dyshimit të arsyeshëm i bazuar në prova të mjaftueshme se i dyshuari \*\*\*. \*\*\*. ka kryer veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i K. Penal dhe “Ndotja e ujërave”, të parashikuar nga neni 203/1 i K. Penal; ...ekziston rreziku që, për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit, nga ana e tij të kryhen krime të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilën procedohet, pasi kryerja e veprimit kriminal të ndërtimit të paligjshëm dhe të ndotjes së detit, e dëshmon një gjë të tillë... dhe faktit që ai është i dënuar [...], ka kërkuar vleftësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, për shtetasin \*\*\*. \*\*\*, dhe “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, për shtetasin \*\*\*. \*\*\*, i akuzuar për veprën penale të “Dhënie e ndihmës për ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/b i K. Penal.

12.5 Nga regjistrimi audio i seancës gjyqësore të datës \*.1.2017, administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar qëndrimin e tij mbi caktimin e masës së sigurisë, nga “Arrest me burg”<sup>19</sup>, kërkesë fillimisht e paraqitur prej tij dhe e kërkuar në Gjykatë, në masë të “Garancisë pasurore”, e kërkuar përfundimisht në seancë. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim, në përgjigje të pyetjes së përsëritur të gjyqtarit të seancës, ka deklaruar, ndër të tjera: [...] mendon se kjo masë i plotëson nevojat e sigurimit, dhe të pranohet kërkesa e mbrojtësit për vendosjen e sigurisë “Garanci pasurore” [...].

12.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me vendimin nr. \*-2017-\*, datë \*.1.2017, ka caktuar si masë sigurimi “Garanci pasurore” në shumën 500.000 lekë, duke konkluduar, ndër të tjera, se edhe në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 244/3 i K. Pr. Penale, sipas të cilit “Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”, ka caktuar atë masë që kërkoi prokurori në kërkesat përfundimtare.

12.7 Sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime për sa më sipër konstatuar, pasi mbetej e paqartë mënyra e formulimit të kërkesës përfundimtare për caktimin e masës së sigurimit “Garanci pasurore”, duke dhënë dhe shpjegime se cilat ishin shkaqet mbi të cilat është mbështetur, pse ishte e përshtatshme kjo masë dhe se si kishin ndryshuar ato.

12.8 Në vijim, Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, ka çmuar se ndryshimi i masës së sigurisë nga ana e subjektit është bërë në përputhje me kërkesat dhe

---

<sup>19</sup> Masë sigurimi, që duket se është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit fillimisht, kjo si rezultat i deklaramit në seancë gjyqësore, në minutat 07:25 dhe 12:14 të regjistrimit audio.

kriteret e përcaktuara nga neni 260 i K. Pr. Penale dhe nuk evidentohen shkaqe apo *indicie* që dëshmojnë për qëllime favorizimi të palës në çështjen penale në fjalë.

12.9 Komisioneri Publik vëren se të dhënat e çështjes së sipërtrajtuar janë të identifikueshme dhe në shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022, të DSIK-së. Në këto rrethana, në konsideratë dhe të indicieve të dhëna nga organet ligjzbatuese, në analizë të rastit konkret, Komisioneri Publik vlerëson se ndryshimi i masës së sigurisë nga subjekti i rivlerësimit, dhe pas administrimit të prapësimeve të subjektit dhe akteve të vëna në dispozicion, mbetet i paqartë dhe i paargumentuar, për sa kohë rezulton se:

(1) Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Rajonale e Qarkut Vlorë, me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.2.2017, për rastin konkret, ndër të tjera, ka bërë me dije se AKM - Qarku Vlorë nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ujit për të vlerësuar dëmin e shkaktuar në ekosistemin ujor detar nga subjekti që ka shkaktuar ndotjen<sup>20</sup>.

(2) Nga vendimi “Për pushimin e çështjes në procedimin penal nr.\*\*\* të vitit 2017 (bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\* të v. 2017), konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë ka regjistruar një tjetër kallëzim penal në datën \*\*.1.2017, konkretisht procedimin penal nr. \*\*\* (nr. \*\*\* kallëzimi, datë \*\*.1.2017), nga ku rezulton se po i njëjti shtetas, më datë \*\*.1.2017, është “arrestuar në flagrancë” sërish nga Policia Gjyqësore për veprën penale “Ndotja e ujërave”, parashikuar nga neni 203 i K. Penal. Pas referimit nga Policia Gjyqësore, prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/2017, dhe i është drejtuar Gjykatës për vleftësimin e masës së sigurisë “Arrest me burg”. Gjykata Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2017, ka vleftësuar të ligjshëm “arrestimin në flagrancë” të shtetasit \*\*\*. \*\*\*. dhe caktimit ndaj tij të masës së sigurimit “arrest me burg”, me afat 7 ditë, sipas nenit 238 të K. Pr. Penale.

(3) Nga vendimi i pushimit rezulton se ky procedim penal është bashkuar me procedimin nr. \*\*\*/2017, të sipërtrajtuar dhe bazuar, ndër të tjera, dhe në përgjigjen e AKM - Qarku Vlorë, është vendosur pushimi i çështjes së procedimit penal nr. \*\*\*/2017.

12.10 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se çështja e referuar në Raportin e DSIK-së, në rastin konkret, duket se tregon ekzistencën e elementeve të nevojshme për t’u çmuar nga Kolegji gjatë shqyrtimit gjyqësor të vendimit nr. 704/2023, së bashku eventualisht me gjetjet e tjera të këtij ankimi, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të aplikimit të nenit 61, pika 5 të po këtij ligji.

### **13. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2018, në ngarkim të pandehurit, shtetasit \*\*\* \*\*\*, për veprën penale “Drejtimit i automjetit në mënyrë të parregullt”**

13.1 Rrethanat e faktit. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialeve të dërguara nga Komisariati i Policisë Rrugore, Sarandë. Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Komisaratin e Policisë Sarandë kanë ndaluar pranë qendrës së qytetit një automjet tip autoveturë të markës *Ford*, që drejtohej nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*, i pajisur me leje drejtimi të

<sup>20</sup> [...] ARM nuk mund të japë përgjigje të saktë dhe kompetente, pa u njohur me analizat e ujit dhe mund të shprehet teorikisht për mjetet inerte që janë hedhur në ujin detar. Për një vlerësim të qartë të gjendjes të ekosistemit të trupit ujor detar, ju sugjerojmë të kontraktohet një studio laboratorike e licencuar dhe e akredituar për marrjen e mostrave dhe kryerjen e një studimi, vlerësimi hidro-biologjik të ndikimit në mjedis [...].

*klasit "B". Pas kontrollit të dokumentacionit, personi në fjalë i është nënshtruar testit me aparatit "Drager", dhe pas kryerjes së disa testeve ka rezultuar se shtetasi \*\*\*. \*\*\*. kishte përdorur pije alkoolike në masën 0.69 dhe 0.75 mg/l.*

13.2 Pas sekuestrimit të mjetit dhe dokumentacionit të tij, Policia Gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit \*\*\*. \*\*\*., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i K. Penal, *në formën e drejtimit të mjetit në gjendje të dehur*. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, mbi bazën e këtyre materialeve, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/2018.

13.3 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Gjykatë kërkesën për vleftësim arresti dhe caktim masë sigurimi dhe gjykim i njëkohshëm për shtetasin \*\*\*. \*\*\*., i cili, në seancë, përmes avokatit, ka paraqitur dhe kërkesën për gjykim të shkurtuar, kërkesë kjo e pranuar dhe nga subjekti i rivlerësimit.

13.4 Gjykata, me vendim të ndërmjetëm të datës \*\*.12.2018, nr. \*\*\*, ka pranuar kërkesën e organit të akuzës, duke e vleftësuar të ligjshëm arrestimin, caktimin e masës së sigurimit "Arrest me burg", si dhe gjykimin e njëkohshëm të çështjes penale, nëpërmjet gjykimit të drejtpërdrejtë në gjendjen që janë aktet.<sup>21</sup> Gjykata, në po të njëjtën ditë, ka vazhduar me gjykimin e çështjes, me gjykim të shkurtuar. Gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, përfundimisht, deklarinim fajtor [...] *dënimin me 1 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406/a/1 të gjykimin të shkurtuar, dënimin e shtetasit me 20 ditë burg, të shoqëruar dhe me dënimin plotësues, ndalimin e tij të drejtojë automjete për një periudhë 1-vjeçare*<sup>22</sup> [...].

13.5 Referuar regjistrimit audio të seancës gjyqësore, si dhe procesverbalit të mbajtur për këtë seancë, të administruar në dosje të Komisionit, rezulton se avokati i shtetasit \*\*\*.\*\*\*. ka kërkuar që, për shkak të rrethanave [...] *ky shtetas të dënohet me minimumin e mundshëm, me 10 ditë burgim dhe t'i zbriten ditët në parandalim, si dhe pjesa e mbetur e ditëve të konvertohet me burgim me një pagesë në favor të shtetit*<sup>23</sup> [...]. Nga aktet në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit, në këtë moment procedural, i pyetur nga Gjykata, shprehet se: [...] *është dakord që të konvertohet kjo masë me gjobë*<sup>24</sup> [...].

13.6 Gjykata, me vendimin nr. \*\*-2018-\*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.12.2018, ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasit \*\*. \*\*, si dhe dënimin me 15 ditë burgim, e në aplikim të nenit 406/1, uljen e dënimit me 1/3 e tij, me 10 ditë burgim, zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shumë të hollash në favor të shtetit<sup>25</sup>, vendim i cili, sipas shënimit, ka marrë formë të prerë.

13.7 Komisioni, nga analiza e vendimit të sipërcituar, ka konstatuar se, gjatë kërkesave procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konstatuar problematika/shkelje procedurale që mund të konfirmojë dyshimet mbi favorizim të palës në këtë proces, duke qenë që caktim i masës së dënimit të kërkuar fillimisht prej tij ka qenë brenda marzhit të parashikuar

<sup>21</sup> Sipas kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, duke u kthyer dosja hetimore në dosje gjyqësore.

<sup>22</sup> Neni 291 i K. Penal, për këtë veprë penale, K. Penal ka parashikuar një dënim nga 10 ditë deri në tre vjet burgim.

<sup>23</sup> Min. 08:18 e vijuese e regjistrimit audio të seancës gjyqësore.

<sup>24</sup> Referohuni procesverbalit, si dhe regjistrimit audio të seancës gjyqësore, në minutën 09:40 dhe vijuese, të administruar në dosje të Komisionit.

<sup>25</sup> Bazuar në nenin 53 /a të ligjit nr. 98, datë 31.7.2014 [...] *Kur gjykata... çmon se vepra penale dhe autori kanë rrezikshmëri të ulët... dhe kur cakton një dënim gjer në 2 vjet, mund të vendosë zëvendësimin e dënimit të burgimit me një shumë të hollash* [...].

nga dispozita përkatëse të kësaj veprë penale, duke mos gjetur kështu elemente të mjaftueshme procedurale, që mund të çonin në një favorizim të mundshëm të palës në këtë çështje penale.

13.8 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në rastin konkret, dakordësia e subjektit në drejtim të ndryshimit të masës së sigurisë, gjatë seancës, sipas kërkesave të palës, duket e paargumentuar qartë. Në kushtet kur dhe ky rast është administruar si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, Komisioneri Publik, me këtë bazë të dhënash dhe këtë nivel aksesi mbi informacionin e klasifikuar, nuk identifikon nëse ndryshimi i masës së sigurisë për shtetasin \*\*\*. \*\*\*. ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës.

#### **14. Kërkesë e datës \*\*.1.2017, për gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. \*\*\*/2017, në ngarkim të shtetasit \*\*\* \*\*\*, akuzuar për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**

14.1 Komisioneri Publik konstaton se në dosje të Komisionit, për rastin konkret, gjendet e administruar vetëm kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, “*Për gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. \*\*\*/2017, në ngarkim të pandehurit \*\*\* \*\*\**”.

14.2 *Rrethanat e faktit.* Nga kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë, duket se shtetasi \*\*\*. \*\*\*. ka konsumuar elementet e veprës penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i K. Penal. Vepra penale për të cilën dyshohet se ka kryer shtetasi i dyshuar, është një vepër për të cilën ligji penal ka përcaktuar një sanksion me burgim, nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

14.3 Subjekti i rivlerësimit, që ka përfaqësuar organin e akuzës, ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”, si dhe gjykimin e menjëhershëm të këtij procedimi.

14.4 Komisioni nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara, por edhe nga të dhënat e disponuara, nuk ka evidentuar shkelje procedurale apo veprime, apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të shtetasit në çështjen e analizuar, për aq kohë sa kërkesat në këtë fazë të hetimit kanë qenë në përputhje me dispozitat e nenit 291 të K. Pr. Penale dhe nr. 400/1/2 etj., të K. Pr. Penale.

14.5 Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet në dosje, në mungesë të informacionit të plotë të organeve ligjzbatuese dhe arsyes të administrimit të kësaj çështje dhe ecurisë së saj, nuk vlerëson dot nëse rasti konkret ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë rrethana për t’u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

#### **15. Procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2016, i pezulluar, i cili bën fjalë për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137 i K. Penal**

15.1 Komisioneri Publik konstaton se në dosje të Komisionit, për rastin konkret, gjendet e administruar vetëm vendimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, “*Për pezullimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016*”.

15.2 Rrethanat e faktit. Mbi bazën e materialit referues të Komisarariatit të Policisë Sarandë, Prokuroria pranë kësaj gjykate ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2016, për veprën penale të “Vjedhja e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137 i K. Penal.

15.3 Gjatë kontrollit të ushtruar nga Njësia Operacionale e Energjisë Elektrike në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në qytetin e Sarandës, më datë **\*\*8.2016**, në një ndërtesë që ndodhej në rrugën e pestë të këtij qyteti, kanë konstatuar se matësi i energjisë elektrike dukej i dëmtuar nga pamja vizuale dhe vula në këtë matës, me nr. \*\*\* nuk figuronte në sistemin e OSHEE-së. Nga verifikimet ka rezultuar se ky matës i përkiste abonentit \*\*\* \*\*\*, me numër kontrate \*\*\*.

15.4 Nga vendimi duket se Policia Gjyqësore ka pyetur shtetasin \*\*\*. \*\*\*, i cili ka deklaruar se është djali i shtetases \*\*\* \*\*\*, e cila jeton në Greqi. Ai ka sqaruar se kanë në pronësi një objekt me katër kate, ku në dy katet e fundit jeton ai me familjen e tij, ndërsa dy katet e tjera i kanë lëshuar me qira pa hartuar kontratë. Fillimisht, dy katet e para i ka pasur me qira shtetasi \*\*\*. \*\*\*. dhe, pas muajit janar të vitit 2015, jetojnë dy familje të tjera.

15.5 Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nuk është bërë i mundur të zbulohen autorët e mundshëm të kësaj ngjarje, duke mos u arritur të përcaktohet periudha kohore kur ka ndodhur ndërhyrja apo cili ka qenë personi konkret që ka kryer këtë ndërhyrje, duke u nisur nga fakti se ky objekt ndër vite ka qenë në përdorim nga persona të ndryshëm, *sipas deklarimeve nga këta shtetas e jo vetëm nga pronari/abonenti* \*\*\*. \*\*\*, si dhe nisur edhe nga fakti se nga OSHEE nuk janë ushtruar kontrole gjatë kësaj periudhe. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, më datë **\*\*12.2016**, ka vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë **\*\*8.2016**, për veprën penale të “Vjedhja e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137 i K. Penal, pasi nuk njihet autori i veprës penale.

15.6 Komisioni, nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara dhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të shtetases \*\*\*. \*\*\* në çështjen penale të sa më sipër analizuar.

15.7 Komisioneri Publik verën se të dhënat e çështjes së sipërtrajtuar janë të identifikueshme dhe në shkresën nr. \*\*\* prot., datë **\*\*10.2022**, të DSIK-së. Në këto rrethana, në konsideratë dhe të indicieve të dhëna nga organet ligjzbatuese, në analizë të rastit konkret, në gjendjen që janë aktet në dosje, në mungesë të ecurisë dhe veprimeve hetimore lidhur me këtë çështje, Komisioneri Publik nuk vlerëson dot nëse rasti konkret ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë rrethana për t’u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

## **16. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë **\*\*5.2020**, që i referohet materialit kallëzues<sup>26</sup> të referuar nga Komisarati i Policisë Sarandë, për veprën penale “Vjedhje me dhunë”**

16.1 Rrethanat e faktit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se, midis shtetasve \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*. ka nisur një konflikt/përleshje fizike që është shoqëruar me dëmtime fizike, si dhe është pretenduar për vjedhjen e një sendi shtetasit \*\*\*. \*\*\*, nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*.

---

<sup>26</sup> Në dosje të Komisionit gjenden të administruara, vendimi për mosfillimin, kopje e njoftimit, referimi i policisë, deklaratat e personave, si dhe procesverbalet përkatëse.

16.2 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim më datë \*\*.6.2020, për *mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. \*\*\*, të vitit 2020*. Në analizim të situatës faktike dhe dokumentacionit, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, ka vlerësuar se veprimet nuk përbëjnë fakt penal, duke orientuar gjithashtu edhe palët për ndjekjen e këtij konflikti në rrugë civile, që parashikojnë edhe shpërblimin e dëmit si një proces që ndiqet drejtpërsëdrejti nga gjykata, nga i dëmtuari akuzues. Për këtë vendim janë njoftuar edhe palët.

16.3 Nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara dhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, shkelje ligjore apo tejkalim të afateve procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të ndonjërit nga palët e përfshira në çështjen penale të sa më sipër analizuar.

16.4 Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet në dosje, në mungesë të informacionit të plotë të organeve ligjzbatuese dhe arsyes të administrimit të kësaj çështje, nuk vlerëson dot nëse rasti konkret ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë premisa për t'u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**17. *Lidhur me gjetjet nga denoncimet.*** Komisioni, në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik, ndër të tjera, konstaton sa në vijim:

**18. *Denoncim i shtetasit \*\*\*, \*\*\*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.1.2019***

18.1 Ky shtetas, ndër të tjera, pretendon se prej vitesh ka mbetur dyerve të drejtësisë, pasi i është hequr pa të drejtë licenca në ushtrimin e aktivitetit në fushën e transportit të udhëtarëve ndërqytetas Delvinë-Tiranë, nga kryetari i Bashkisë \*\*\*, \*\*\*, duke ia dhënë këtë licencë djalit të xhaxhait të tij, në konflikt interesi dhe me dokumente të falsifikuara. Denoncuesi pretendon se Gjykata ka rrëzuar Prokurorinë për herë të dytë, duke e urdhëruar të vijojë hetimet (gjykimi i fundit \*\*.1.1019) dhe se prej 18 muajsh nuk është thirrur asnjëherë për t'u pyetur nga Prokuroria e Sarandës, në lidhje me këtë hetim. Bashkëlidhur denoncimit ka paraqitur dhe aktet në mbështetje të pretendimeve të tij.

18.2 Nga aktet bashkëlidhur rezulton se shtetasi \*\*\*, \*\*\*, ka paraqitur, në datën \*\*.8.2016, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, kallëzimin penal, kundër kryetarit të Bashkisë Delvinë, shtetasit \*\*\*, \*\*\*, për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i K. Penal, duke kallëzuar, ndër të tjera, se shtetasi \*\*\*, \*\*\*, ka dhënë licencë te djali i xhaxhait të tij, në kundërshtim me ligjin.

18.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.9.2016, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. \*\*\* të v.2016 [...] pasi, pas analizës së materialit kallëzues dhe bazuar në materialet e tjera shkresore bashkëngjitur tij, konstatojmë se ekzistojnë shkaqe ligjore, të cilat nuk lejojnë fillimin e procedimit penal [...]. Denoncuesi, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, ka ankumuar vendimin e subjektit të rivlerësimit, për mosfillimin e procedimit penal.

18.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me vendimin nr. \*\*-2017-\*\*\*, datë \*\*.3.2017, ka pranuar ankimin e shtetasit \*\*\*, \*\*\*, duke argumentuar, ndër të tjera, se vendimi i subjektit të rivlerësimit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe se analiza juridike është e gabuar dhe nuk gjen mbështetje në ligj, duke e prishur atë<sup>27</sup>. Gjykata ka arsyetuar se [...] *Ankuesi \*\*\*, \*\*\*, ka kallëzuar në Prokurorinë... faktin se sipas tij nga ana e Bashkisë Delvinë është miratuar një licencë e transportit ndërqytetas në favor të subjektit “\*\*\*” sh.p.k., pronar i së cilës është shtetasi \*\*\*, \*\*\*, djali i xhaxhait të kryetarit të Bashkisë Delvinë. Sipas ankuesit, procesverbale të disponon Bashkia Delvinë mbi miratimin e licencave në favor të këtij subjekti janë të falsifikuara, pasi Komisioni i Licencimit nuk është mbledhur dhe nuk ka operuar asnjëherë dhe këto procesverbale nuk janë nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të licencimit, por nga njerëz të tjerë. Po kështu sipas tij, kryetari i Bashkisë Delvinë ishte në konflikt interesi [...]. Në këto kushte, Gjykata ka çmuar se këto drejtime duhet të ishin hetuar nga prokurori dhe jo të merrte menjëherë apriori vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit.*

18.5 Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. \*\*-2017-\*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.5.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar *procedimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2017*, ndërkohë ka vendosur dhe ndarjen e akteve të këtij procedimi në dy procedime penale: **(1)** nr. \*\*\*/2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe **(2)** nr. \*\*\*/2018, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, neni 186 i K. Penal, ku ky i fundit i është dërguar për kompetencë tokësore, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

18.6 Nga aktet rezulton se, dhe pas vendimit të dhënë nga Gjykata, subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimeve, ka paraqitur sërish në Gjykatë, më datë \*\*.11.2018, *kërkesën për pushimin e procedimit nr. \*\*\*/2017*, kërkesë për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me vendimin nr. \*\*-2019-\*\*\*, datë \*\*.1.2019, ka vendosur rrëzimin, kthimin e akteve prokurorit, vazhdimin e hetimeve, duke i kryer ato brenda afatit 3-mujor. Ky vendim është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. \*\*-2019-\*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.2.2019.

18.7 Pas kthimit të akteve nga Gjykata dhe kryerjes së disa veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.1.2020, ka shpallur moskompetencën dhe kalimin e akteve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK. Kjo e fundit, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/2020, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*/2017, ndërkohë me dërgimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*/2018 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka bërë bashkimin e procedimeve penale në një të vetëm, atë me nr. \*\*\*/2022.

18.8 Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime për sa më sipër është cituar, lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore dhe mosadministrimin e provave.

18.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Pas ankimit të kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë ka pranuar ankimin, vendim i lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër... Sqaroj se këtë periudhë ushtrroja detyrën e*

---

<sup>27</sup> Gjykata ka orientuar për hetime të mëtejshme dhe administrim të provave dhe hetimin lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit.

prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë... dhe hetimet ndërkohë, në lidhje me çështjen në fjalë janë ndjekur nga Drejtuesi i Prokurorisë. Ky i fundit ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes. Kërkesa është rrëzuar nga Gjykata, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*-2019-\*\*\*/\*\*, datë \*\*.2.2019. Pas kthimit të akteve jam ngarkuar sërish me hetimin e kësaj çështjeje dhe, në datën \*\*.1.2020, kam vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjithashtu, materiali kallëzues i shtetasit \*\*\*, \*\*\*, është ndjekur dhe nga ILD<sup>28</sup>, e cila, me vendimin nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*.7.2023, ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi ka vlerësuar se veprimet e ndjekura nga ana ime gjatë periudhës që kam qenë i ngarkuar në hetimin e këtij rasti kanë qenë të arsyeshme [...].

18.10 Komisioni, krahas shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vendimit të lartpërmendur të ILD-së, ka çmuar se në këtë rast subjekti nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet paraprake verifikuese/vlerësuese dhe hetimore, në kohën dhe mënyrën e duhur, përpara se të mbërrinte në vendimin e mosfillimit nr. \*\*\*, viti 2016. Nisur nga fakti se subjekti fillimisht ka vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe më tej, pas vendimit të Gjykatës për urdhërimin e kryerjes së hetimeve, është vlerësuar dhe shprehur moskompetencë lidhur me këtë çështje/procedim [...] *evidenton mungesën e mjaftueshmërisë në kryerjen e hetimeve e vlerësimeve fillestare nga ana e tij. Megjithatë, kjo çështje e vetme nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit profesional [...].*

18.11 Komisioneri Publik konstaton se në rastin konkret duket se pretendimet e denoncuesit janë të mbështetura nga rezultatet e hetimit. Moskryerja e veprimeve hetimore të nevojshme dhe arsyetimet e pabazuara të subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes, e konfirmuar në dy raste edhe nga kontrolli gjyqësor, duket se afekton kriterin e aftësisë profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara, në rastin konkret, janë të vlefshme për t'u trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

## **19. Denoncim i shtetasit \*\*\*, \*\*\*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2022**

19.1 Në denoncimin e tij, ky shtetas shpjegon se ka bërë 2 kallëzime pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Sarandë: (1) më datë \*\*.4.2020, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, neni 199/a i K. Penal dhe (2) atë “Shpërdorimit të detyrës”, neni 248 i K. Penal dhe të “Moskallëzimit të krimin”, neni 300 i K. Penal, të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës për të parën, pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2020 dhe për kallëzimin e dytë mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020. Për të dyja rastet nga Gjykata është vendosur vijimi i hetimeve.

19.2 Komisionit, nga kontrolli në sistemin *online* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, i ka rezultuar se:

19.2.1 Rrethanat e faktit për procedimin penal \*\*\*, datë \*\*.4.2020. Kallëzuesi, shtetasi \*\*\*, \*\*\*, është pronar i një banese të ndodhur në lagjen nr. \*\*, të qytetit Sarandë. Ky shtetas pretendon se shtetasi \*\*\*, \*\*\*, ka blerë bodrumin e pallatit, i cili ka shërbyer në të kaluarën si

<sup>28</sup> Në vendimin e ILD-së, të administruar në dosje të Komisionit, gjendet dhe historiku i procedimit penal nr. \*\*\*/2017.



kabinë elektrike. Gjatë kësaj kohe, ky person është duke kryer punime dhe po gërmon themelet e pallatit, ka prishur gjithë strukturën mbajtëse të pallatit etj. Nga këto punime, pretendon kallëzuesi, po rrezikohet jeta e të gjithë banorëve. Mbi bazën e këtij kallëzimi është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2020, për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i K. Penal.

19.2.2 Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës \*\*.10.2020, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2020, duke argumentuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Po ashtu, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se, njëkohësisht në rrethanat e faktit, nuk konstatohen dhe nuk ka dyshime për ekzistencën e elementeve të ndonjë veprë tjetër penale, sikurse mund të jetë ajo e “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K. Penal. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesi.

19.2.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*-\*\*\*-\*\*\*-2021, të datës \*\*.5.2021, ndër të tjera, ka çmuar se në kushtet kur shtetasi \*\*\*. \*\*\*, ka kallëzuar lidhur me punimet që kryheshin nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*, objekt kryesor i hetimeve duhet të ishte vepra penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K. Penal, hetime këto të cilat për këtë vepër çmohet se *janë të paplota*. Gjykata urdhëroi prokurorin të plotësojë hetimet në funksion të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020, në drejtim të qartësimit të plotë të çështjes.

19.2.4 Nga aktet në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së veprimeve hetimore, ka paraqitur në Gjykatë (datë regjistrimi \*\*.1.2021), sërish kërkesën për “Pushimin e procedimit penal me nr. \*\*\*/2020”, për veprën penale “Shkatërrim i pronës”.

19.2.5 Ndërkohë, nga aktet, rezulton se Prokuroria Sarandë, po mbi bazën e kallëzimit të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, kishte regjistruar një kallëzim tjetër penal, atë me nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2020, i cili bën fjalë për “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i K. Penal, “Pushtimi i tokës”, të parashikuar nga neni 200 i K. Penal, “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K. Penal, “Moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

19.2.6 Për këtë procedim, subjekti i rivlerësimit, më datë \*\*.11.2020, ka marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\*/2020, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *në drejtim të faktit të kallëzuar nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*, janë kryer hetime në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*/2020 [...].* Një kopje e akteve të këtij procedimi është administruar dhe është bërë pjesë e fashikullit të materialit kallëzues me nr. \*\*\*/2020. Pas shqyrtimit të provave të administruara, *subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqe ligjore që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale.* Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasi \*\*\*. \*\*\*.

19.2.6.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me vendimin nr. \*\*-2021-\*\*\*, datë \*\*.7.2021, ka vendosur “Pranimin e ankimit”, të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2020, detyrimin e Prokurorisë të regjistrojë procedimin penal dhe të vazhdojë hetimet.

19.2.7 Subjekti i rivlerësimit, në këto rrethana, në kushtet kur kishte regjistruar në Gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2020, në seancën gjyqësore të datës \*\* korrikut 2021, duket se ka kërkuar: [...] *tërheqjen e akteve dhe kthimin e tyre pranë Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, për të proceduar më tej duke bashkuar dy procedime*

*në një të vetëm, për të vijuar më tej hetimet dhe për të ngritur akuzë ndaj personave që do të merren si të pandehur [...].*

19.3 Subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues i organit të akuzës, në këtë seancë ka relatuar se, pasi janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata, nga administrimi i aktit të ekspertimit, është konkluduar se nga ana e të kallëzuarit është kryer ndërtim i paligjshëm, pasi ndërtimi është kryer pjesërisht në tokë të vet dhe pjesa tjetër në tokë publike, ndërsa për punonjësit e IMT – Bashkisë Sarandë, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, *kallëzimi nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2020*, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

19.4 Gjykata, me vendimin nr. \*\*-2021-\*\*\*, datë \*\*.7.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, për tërheqjen e akteve dhe kthimin e tyre pranë kësaj Prokurorie. Në vijim, subjekti, më datë \*\*.10.2021, ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. \*\*\* me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2020 (kallëzimi nr.\*\*\*, datë \*\*.11.2020), dhe vazhdimin e hetimeve në një procedim të vetëm, me nr. \*\*\* të vitit 2020, për veprën penale “Shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i K. Penal, “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 i K. Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

19.5 Sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore shteruese/ezauroese dhe të thelluara, si mungesa e aktit të ekspertimit në fushën inxhinierike, në funksion të procedimin penal nr. \*\*\*/2020 dhe lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore të thelluara, duke depozituar edhe dokumentacionin lidhur me vijimësinë e procesit në vijimësi lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2020.

19.6 Subjekti i rivlerësimit, duke parashtruar ecurinë e procedimeve penale, sa më sipër trajtuar, ndër të tjera, ka deklaruar se të dhënat e mësipërme pasqyrojnë veprimtarinë e tij hetimore në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*/2020 deri në datën \*\*.10.2021, pasi në këtë periudhë ai, me vendimin nr. 313 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është transferuar me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat.

19.7 Në përfundim, Komisioni, për sa më sipër, ka arsyetuar se çështja në analizë, ndonëse evidenton moskryerjen e hetimeve të plota, sipas vlerësimit të Gjykatës – në mungesë të një serie problematikash të përsëritura dhe me pasoja konkrete, të cilat mund të evidentonin një *modus operandi* të papërshtatshëm dhe/ose mangësi të theksuara profesionale – kjo rrethanë nuk mund të mjaftojë në vetvete për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

19.8 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se dhe në rastin konkret duket se qëndrojnë pretendimet e denoncuesit dhe për më tepër moskryerja e veprimeve hetimore të nevojshme dhe arsyetimet e pabazuara të subjektit të rivlerësimit për pushimin apo mosfillimin e çështjes, janë konfirmuar në dy raste edhe nga kontrolli gjyqësor, rrethana këto që duket se afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatoreve të parashikuar prej nenit 73, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara, në rastin konkret, janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**20.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara në fashikull në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk vlerëson dot nëse subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**21.** Bazuar në nenin Ç, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 704, datë 9.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**